

Disa funksione më të përbëra

Futja e funksioneve

Funksionet mund të futen në dy mënyra :

Mënyra e parë është me të shkruarit direkt ku te qeliza futet shenja për barazi (=), pastaj emri i funksionit dhe argumentet sipas sintaksës së funksionit. Ndërsa mënyra e dytë është nëpërmjet dritares për futje të funksioneve. (Shiko videon [ketu](#))

Funksioni COUNT – përdoret për të numëruar qelitë prej ndonjë vargu te të cilat gjendet ndonjë vlerë numerike. Sintaksa e funksionit është:

Sintaksa = COUNT(range)

Në të cilën range paraqet vargun e qelive të cilët shqyrtohen psh. =COUNT(A1:A9)

Funksioni COUNTA- Shfrytëzohet për numërim të qelizave prej ndonjë vargu të cilat përmbajnë çfarëdo vlere (numër, tekst)

Sintaksa

= COUNTA(range)

Në të cilën range paraqet vargun e qelive të cilët shqyrtohen psh.=COUNTA(A1:A9)

Funksioni COUNTIF shfrytëzohet për numërim të kushtëzuar, d.m.th., i numëron qelizat prej vargut vlerat e të cilit e kënaqin kriterin e dhënë.

Sintaksa

= COUNTIF(range , criteria) Në të cilën range është varg i qelizave të cilat hulumtohen (për shembull, E3:E10), por criteria/kriter

është kusht logjik vlere e të cilit te qeliza patjetër ta plotësojë për të numëruar (për shembull, “>10”).

psh. =COUNTIF(A1:A9;”>2”)

Funksioni SUMIF/SHUMANËSE shfrytëzohet për mbledhje të kushtëzuar, d.m.th., mbledh vlere te qelizat prej ndonjë vargu për të cilin është plotësuar kushti logjik i caktuar.

Sintaksa

=SUMIF(range , criteria, range_of_sum)

Në të cilën range/vargu është varg i qelizave të cilat shqyrtohen (për shembull, C1:C10),

criteria/kriteri është kusht logjik i vlerës te qeliza patjetër ta plotësojë që të mblidhet (për shembull, “>3”)

range_of_sum është argument i padetyrueshëm i cili shfrytëzohet vetëm nëse kërkohet shuma e qelizave të cilat nuk janë vargun e njëjtë me qeliza për të cilët shqyrtohet kushti i dhënë

Funksioni IF -është funksion i kushtëzuar .

Sintaksa

=IF(test, then_value,otherwise_value)

Kontrollon vallë kushti i përmendur te fusha Logical test/teste i plotësuar- nëse është plotësuar, funksioni do të ketë vlerë e cila është dhënë te fusha

Value_if_true/atëherë vlere, nëse kushti nuk është plotësuar, funksioni do të ketë vlerë e cila është dhënë te fusha Value_if_false/përndryshe vlere.

Pjesën praktike e keni këtu ([pjesa praktike](#))

Pyetje

1.

	A	B
1	1	
2	2	
3	3	
4	p	
5	w	
6	4	
7	10	

Sa do të jetë rezultati i funksioneve

- a) COUNT(A1:A7) b) COUNTA(A1:A7) c) COUNTIF(A1:A3,">2")
d) SUMIF(A1:A3;">2") E) IF(A1=A2;"po","jo")